REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS-MALISHEVË
THE MUNICIPAL ASSEMBLY-MALISHEVË-SKUPŠTINA OPŠTINE MALIŠEVO

PRANUAR MË:
ACCEPTED ON: 30/10/2026
PRIMLJENO:
Nr.No.Br. 02/330

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Nr. 02/_____
Datë:13.10.2026

P r o c e s v e r b a l
i mbledhjes së -IV-(katër) të rregullt të Komitetit për Komunitete

**Koha:** 13.10.2026 ora 09:15
**Vendi** :Salla e mediave

**Të pranishëm**:Kryesuesi i Komitetit për Komunitete z.*Fitim Shala*,anëtarët e komisionit:*Hafir Rexha*, *Nurije Islamaj*, *Naser Malisheva*.
Drejtori për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale z.*Amrush Helshani,* përfaqësues nga zyra e informimit.

Mbledhjen e udhëheqi dhe e kryesoi Kryesuesi i Komitetit për Komunitete z.*Fitim Shala* meqenëse konstatoi se korumi ishte i mjaftueshëm për mbajtjen e seancës e vuri në votim rendin e ditës si në vijimë:

Rendi i ditës

1. *Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.*
2. *Takim me drejtorin e drejtorisë së shëndetësisë z.Amrush Helshani.*
3. *Të ndryshme.*

Rendi i ditës u miratua.
Rezultati i votimit:4 **për**, 0 **kundër,** 0 **abstenim.**

Pika 1

Pika e parë e rendit të ditës: *Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.*
Kryesuesi i Komitetit për Komunitete z.*Fitim Shala* konstatoi se me vota unanime u miratua Procesverbali nga mbledhja e kaluar.
Rezultati i votimit:4 **për**, 0 **kundër**, 0 **abstenim.**

Pika 2

Pika e dytë e rendit të ditës: *Takim me Drejtorin e drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale z.Amrush Helshani.*

*Fitim Shala*(Kryesues i Komitetit):Ne në planin e punës vjetore e kemi caktuar që në muajin Tetor ta ftojmë Drejtorin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për shkak që ndërlidhet me shumë aktivitete të rëndësishme sepse të gjitë e dim që muaji Tetor është muaji i Ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit.Unë dëshirojë me falenderu *z.Amrushin* sepse ka qenë udhëheqës i këtij Komiteti në mandatin e kalaur dhe ne kemi qenë në kontaktë të vazhdueshëm gjatë hartimit të planit të punës dhe aktivitetet e tjera që ndërlidhen me komunitete.Gjithashtu e falenderoj Drejtorin dhe stafin e tij për punën të cilën është duke e bërë në Drejtorin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.Ne e dim që drejtorin të cilën e udhëheq ka të bëjë me një sektorë të ndjeshëm dhe një sektor primar e cila kujdeset për jetën e qytetarëve të komunës tonë.Drejtor nëse keni mundësi në pika të shkurta me na njoftuar për punën dhe aktivitetet të cilat janë duke u zhvilluar veqanarishtë në muajin Tetor apo muaji Rozë.

*Amrush Helshani*(Drejtor për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale):Përshëndetje për të gjithë!Faleminderit për ftesën,unë me kënaqësi e pranova ftesën dhe e kam konfirmuar pjesëmarrjen për këtë mbledhje.Drejtoria e Shëndetësisë menagjonë një fushë të madhe dhe përbëhet nga një staf i madh të cilën edhe ju e potencuat që aty kryhet një punë e madhe e jashtëzakonshme si nga stafi shëndetësor dhe nga mirëqenia sociale.Janë dy fusha të këtij sektori shëndetësia dhe mirëqenia sociale,kur bëhet fjalë te mirëqenia sociale janë sektor të veqantë,asistenca sociale dhe shërbimi profesional.
Në muajin Tetor,drejtoria për Shëndetësi me zyrën e Kryetarit të Kuvendit të komunës është grupi i grave i cili është aktiv dhe punon në kordinim me Zyrën për barazi gjinore.Ne e kemi përpiluar një agjend e cila i kushtohet muajit të Ndërgjegjësimit kundër kancerit të gjirit,kjo agjend përmbanë fushatë senzibilizuese për gratë të cilat janë të prekura nga kanceri i gjirit.
Nëse i referohemi statistikave të vitit 2025-të janë 1223 pasiente të kontrolluara në shërbimin e radiologjisë,895 raste janë me eho të gjirit,328 raste janë grat të cilan kanë pasur nevojë ti nënshtrohen memografisë,prej tyre 17 janë të diagnosifikuara me kancer të gjirit për komunën e Malishevës ky numër është shumë i madh.Unë uroj që të kemi sa ma pak sëmunje të pacientëve.
Ne si drejtori si institucion jeni të gatshëm me ju dalur në ndihmë sa here që kanë nevojë për mbështetjen institucionale.
Ne e ofrojmë shërbimin paleativ,me të cilën shumë prej rasteve i trajtojmë edhe në shtëpi.Me datën 20 Tetor e kemi marshin paqësor në mbështetje për grat që vuajnë nga kanceri i gjirit,ju ftojë që të jeni pjesë e këtij marshi,e kemi bërë një agjend e cila do të jetë më ndryshe se nga hera e kaluar,do ti ftojmë institucionet dhe gratë të cilat janë në mbështetje për grat që vuajnë nga kjo sëmundje.Nganjëherë ndarja e përvojës me një grua është mbështetje.
Në familjen time kemi pasur raste që jemi ballafaquar me këtë sëmundje dhe aty e kam kuptuar se roli i asaj gruaje që e ndanë përvojnë me një tjetër,ndonjëherë e shëronë edhe me fjalë,thjeshtë është një mbështetje.
Ne jemi të gatshëm me ju dalur në ndihmë edhe moralishtë.Unë si drejtor i drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale ju kam drejtuar me kërkesë zyrës së Kryetarit si dhe te Kryesuesi i Kuvendit që të gjitha kërkesat e grave,sidomos ato të cilat vuajnë nga kanceri i gjirit sepse edhe ne jemi duke u thirrur në mbështetje të tyre të trajtohen me prioritet kërkesat për ndihmë momentale.

Unë kam takuar drejtor të shkollave të mesme dhe profesionale të komunës së Malishevës me të cilën jemi duke mbajtur ligjerata vetëdijesuese,senzibilizuese për kancerin e gjirit,unë i falenderoj të gjithë drejtorët e shkollave të cilët janë përgjigjur pozitivisht dhe kanë ndihmuar në organizimin e atyre ligjeratave sepse kanceri i gjirit nuk njejh moshë dhe gjini.
Në komunën e Malishevës kemi raste nga gjinia mashkullore që janë të prekur nga kanceri i gjirit.Kërkesat për mamogarfi,kontrrollë të gjirit janë shumë të mëdhaja sidomos kur në këtë muaj është duke u bërë një informim më i madh.

*Fitim Shala*(Kryesues i Komitetit):Uroj dhe shpresojë që këto raste që janë aktive me kancerin e gjirit të evitohen dhe mos të kemi raste të reja.Dëshirojë me bërë një pyetje lidhur me rastet sociale,sa është trendi a është zvogëluar apo është rritur,vitet e fundit në Malishevë?

*Amrush Helshani(*Drejtor për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale):Sektori i asistencës sociale menagjohet prej nivelit qëndror,momenatalisht numri i familjeve që janë përfitues të asistencës sociale është mbi 450,ky numër është në rënie vazhdimisht,sigurisht që për me qenë përfitues i asistencës sociale janë disa kritere që duhet me i përmbushur secila familje që aplikon,është shumë mirë që po bëhet një selektim dhe vërtetë le të dihet se kush ka nevojë me përfituar asistencën socile.

*Naser Malisheva*(anëtar i komisionit):Përshëndetje për të gjithë!Unë e kam një pyetje për drejtorin, lidhur me Qendrën e Mjekësisë Familjare në Kiev,ju falenderojë juve dhe të gjithë të tjerëve që e keni realizuar një punë shumë të mirë,mirëpo aty është laboratori por staf të punëtorëve nuk ka,pra laboratori nuk funksionin edhe pse aty janë të gjitha apraturat e modelit modern.

*Amrush Helshani*(Drejtor për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale):Aty është një Qendër e Mjekësisë Familjare moderne dhe e ka një staf të jashtëzakonshëm që punon vazhdimisht,janë për gjdo lavdat sepse janë në nivel të detyrës.
Ju e keni ngritur me vend shqetësimin,ne jemi duke punuar për funksionalizmin e laboratorit në Kiev për shkak të mungesës së stafit,ne kemi me marrë një laborant sa më shpejt që është e mundur,besoj që në vitin 2027-të kemi me filluar me atë shërbim.
Aty është një qendër e re funksionale është reparti i stomatologjisë,reparti i vaksinimit por edhe laboratorin do ta funksionalizojë shumë shpejtë sepse laboratori i ka pasijet moderne që ndoshta nuk i ka Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare.
Ne jemi të obliguar me hapur laboratorin dhe shumë shpejt kemi me bërë funksional,sepse kjo ka mbetur për shkak të mungesës së stafit profesional.

*Fitim Shala*(Kryesues i Komitetit):Unë ju falenderoj drejtor për bashkëpunimin tuaj në këtë takim.

Pika 3

Pika e tretë e rendit të ditës:*Të ndryshme*.

*Fitim Shala*(Kryesues i Komitetit):E hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës.

*Nurije Islamaj*(anëtare e komisionit):Përshëndetje për të gjithë!Unë e kam një kërkesë,për lagjen "Stapanic "në Kievë,që dy muaj nuk kemi ndriçim publik,të gjitha dritat janë ndalur.

*Fitim Shala*(Kryesues i Komitetit):Faleminderit,e nderuar ne do ta adresojmë këtë qështje në drejtorinë për Shërbime Publike.

Kryesuesi i Komitetit për Komunitete i përfundoi punimet e mbledhjes së -IV-(katër) të rregullt rredh orës 10:00.

Malishevë, *Tetor* 2026 Procesëmbajtsja Kryesues i Komitetit për Komunitete

*Fatlume Delija* *Fitim Shala*